

HALVETIC

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



“Lexo fletudhëzuesin para përdorimit”

HALVETIC është herbicid sistemik total (jo selektiv). Thithet lehtësisht nepermjet gjetheve e lastareve të bimeve dhe leviz me shpejtesi brenda tyre. Halvetic është herbicid me baze glyphosate që bazohet në BGT "Better Glyphosate Technology" inovative dhe e patentuar që siguron efektivitetin e lartë të substancës aktive duke reduktuar përgjysem dozen e përdorimit në krahasim me standartet ekzistuese

Lenda vepruese: 180 g/l Glyphosate (Kripë izopropilamine) (14,83% w/w);
Formulimi: Koncentrat i tretshëm në ujë (SL).

Deklaratat e rezikut:

H412: E dëmshme për organizmat ujorë; duke shkaktuar efekte afatgjata.

EUH401: Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, ndiqni udhëzimet për përdorim

Deklarata paraprake:

P261 - Shmangni frymëmarrjen e pluhurit/tymit/gazit/mjegullës/avujve/spërkatjes.

P262 - Shmangni kontaktin me sytë, lëkurën ose veshjet.

P501 - Hidhni përmbajtjen dhe/ose kontejnerin në përputhje me rregulloret lokale për mbetjet e rrezikshme.

Masat parambrojtëse:

- Largoni personin nga zona e ndotur. Hiqni menjëherë rrobat e njolla ose të spërkatura.
- Në rast kontakti me sytë, shpëlajeni me ujë të bollshëm për të paktën 15 minuta. Mos harroni të hiqni lentet tuaja të kontaktit.
- Në kontakt me lëkurën, lani me shumë sapun dhe ujë pa fërkim.

Udhëzime për ndihmen e parë dhe keshilla për mjekun:

- Në rast gëlltitje, marrje me organet e frymëmarrjes dhe me lekuren, shkakton keto shenja helmimi:dermatit, konjuktivit, vjellje, diare, apati.
- Në rast demtimi, kerkoni ndihme mjekesore në qendrën spitalore me të afërt dhe tregojini mjekut etiketen.
- Nuk njihet antidot specifik. Mjekimi simptomatik.

Përdorimi:

HALVETIC është një herbicid i pas mbirjes, me veprim total, duke kontrolluar si barërat gjethëgjëra ashtu edhe ato gjethengushta në fazën e rritjes aktive. Pas marrjes nga gjethet ai qarkullon me lëngjet bimore në të gjitha pjesët, veçanërisht në ato nëntokësore. Nuk lë mbetje në tokë, prandaj tokat e trajtuara me HALVETIC mund të mbillen pak ditë pas trajtimit me të gjitha llojet e kulturave. Përdoret në kontrollin e barërave të këqija në agrume, farore, bërthamore, ullinj, vreshta, trëndafilishte, etj. Nuk rekomandohet në strukturat mbrojtëse të hapura (tunele për kultivimin e bimeve, rrjeta kundër breshërit, rrjeta hijezuese apo mbrojtëse termike).

Koha optimale për kontrollin e barërave të këqija:

- Barërat e këqija graminore një vjeçare: Trajtoni vetëm kur vërehet dalja e plotë e një gjetheje jeshile në zhvillim aktiv. Për shembull, bari i zakonshëm behet i ndjeshëm kur bimët kanë 4-5 gjethe me gjatësi 10-15 cm. Është më mirë të trajtohet kur bima është në rritje aktive dhe/ose afër lulëzimit, por përpara se të fillojë plakja.
- Barërat e këqija shumëvjeçare gjethëgjëre: Trajtimi është më i mirë kur bima është në rritje aktive dhe/ose afër lulëzimit, por përpara se të fillojë plakja.
- Barërat e këqija gjethëgjëra njëvjeçare: Në fazën e rritjes aktive, me sipërfaqe të mjaftueshme gjethesh për të thithur produktin. Barërat e këqija që dalin pas trajtimit nuk do të kontrollohen. Barërat e këqija njëvjeçare duhet të kenë gjethe 5 cm të gjata; Barërat e këqija gjethëgjëre duhet të kenë të paktën dy gjethe të vërteta të shpalosura përpara aplikimit.

Doza e përdorimit: Për përdorim në bujqësi, doza maksimale është 4-7 l/ha. Në pemtore, arvore, ullishte dhe agrume përdoret 4-7 lit/ha duke synuar pjesët midis rreshtave të pemeve, shkalla e aplikimit për ha shprehet për njësi të sipërfaqes

se trajtuar. Keshillohet perdorimi ne fazat e para lulezimit dhe deri ne formimin e kokrave kur lartesia e bererave eshte e vogel dhe qe perkon me fazen e zhvillimit BBCH-65 deri BBCH 89, ndersa tek hardhia ne fazen BBCH 79 deri BBCH 89 qe perkon me fillimin e lidhjes se kokrave.

Vërejtje për përdorimin:

Shmangni kontaktin e pikave spërkatëse me kulturat e tjera bujqësore. Mos spërkatni ne ditë me erë. Mos trajtoni barërat e këqija të cilat vuajnë nga strese të ndryshme si thatësia, të ftohtit, etj.

Përdoret ekskluzivisht në kohën dhe për qëllimet e parashikuara në këtë etiketë. Çdo përdorim tjetër do të ishte me reziqe. Normat maksimale të mëposhtme të aplikimit nuk duhet të tejkalohen nëse rezultati i vlerësimit të rrezikut të ndërmarrë për përdorimet specifike tregon se një normë më e lartë nuk çon në ndonjë efekt të papranueshëm për gjitarët e vegjël barngrënës:

- Për përdorim në bujqësi: 1,44 kg glifosat/ha/vit; - Për përdorim për të kontrolluar barerat e dëmshme në zonat bujqësore dhe jo bujqësore: 1,8 kg glifosat/ha/vit; - Për përdorim në zonat jo bujqësore: 3,6 kg glifosat/ha/vit.

Kufizime ne perdorim:

-Mos spërkatni barërat e këqija të stresuara nga uji, në tokat e ngopura me ujë, në mot të nxehtë ose në prani të ngricave, pasi kontrolli mund të reduktohet.

-Mos spërkatni bimësinë e lagësht (vesë, pas shiut).

-Në rast shiu: mos spërkatni 6 orë para parashikimit të shiut. Shiu që bie brenda 1 ore pas spërkatjes mund të zvogëlojë efektivitetin e produktit.

– kur era krijon mundësinë e rrjedhjes së lëngut spërkatës në kulturat fqinje.

- rekomandohet përdorimi i produktit jashtë periudhave të aktivitetit të bletës

Përdorimi të minimizohet ose ndalohet në zonat specifike të listuara në VKM-në Nr. 317, datë 15.5.2019, “Për miratimin e

rregullave për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe kriteret e kualifikimit për përdoruesit”.

Fitotoksiciteti:

Nuk është fitotoksik kur përdoret sipas rekomandimeve të mësipërme. Mos e përzieni HALVETIC në rezervuarin e spërkatjes me adjuvante, produkte të tjera fitosanitare ose plehra, përveç nëse rekomandohet nga prodhuesi.

Ndikimi ne ekosistem:

Mos ndotni ujrat dhe basenet ujore me produktin ose ambalazhin e tij.

Spe 1: Për të mbrojtur ujërat nëntokësore, mos e aplikoni produktin gjatë ngjarjeve të reshjeve intensive.

Spe 3: Për të mbrojtur organizmat ujorë, mbani një zonë tampon 5 metra të patrajtuar në trupat ujorë sipërfaqësorë.

Spe 3: Për të mbrojtur bimët jo të synuara, mbani një zonë tampon të patrajtuar deri në zonën e pa kultivuar, me 5 m.

Karenca:

Nuk aplikohet.

Magazinimi:

Preparati ruhet ne vende te erreta pa diell dhe pa lageshti, ne temperature 0° C - 30° C.

Nr dhe data e regjistrimit: 19; 4.7.2025;

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: deri 5 lit.

Data e prodhimit..... ;

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkeseva të përcaktuara): 3 vjet;

Numri i partise se mallit (serise) ose shenja te tjera identifikuese;

Tipi i ambalazhit baze: shishe HDPE (High density polyethylene).

Emri dhe adresa e Aplikantit: Qemetica Agricultural Solutions Poloni SA. **Adresa:** Nowa Sarzyna, Poloni.

Emri dhe adresa e fabrikuesit te PMB-se: Qemetica Agricultural Solutions Poloni SA. **Adresa:** Nowa Sarzyna, Poloni.

Emri dhe adresa e ambalazhuesit (kur ambalazhimi kryhet ne Republiken e Shqiperise):